



ARGUMENTUM

news opinion analysis

A full-page photograph of Emmanuel Macron, President of France, standing in front of the French and European Union flags. He is wearing a dark suit, white shirt, and dark tie. The background shows a balcony with a clock and greenery.

**Fitoi Macron,
Franca dhe
Europa!**

-Serbia mes dy Botëve

-Dritan Abazoviç
zgjidhet kryeministër
i Malit të Zi

-Pope Francis:
“The world is at war”

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Në tre vjetorin e themelimit të kësaj media online, **Argumentum.al** tashmë vjen në versionin e një reviste të përmuajshme të cilën mund ta shfletoni online nga muaji **PRILL 2022**.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në vend, rajon, Europë dhe në botë.

Argumentum.al përpiket të jetë burim

autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle

materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë **Argumentum.al** është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten

Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 “KREMTIMI I PASHKËVE KATOLIKE”

Arqipeshkvi Arjan Dodaj përcjellë mesazhin e tij për festën e Pashkës/ Drita e prezencës së Zotit nuk e braktis kurrë njeriun!

06 ANALIZA

Fitoi Macron, Franca dhe Europa!

09 REALPOLITIK

Putini “fiton” në Beograd dhe Budapest! Beteja për Elyseen dhe Europën! Jo-ja gjermane për Ballkan i Hapur! Sofja foli, po Shkupi?

11 JO VETEM LAJM

Shqipëria, porta për në tregun evropian të gazit natyror

16 FOKUS

Serbia mes dy Botëve

21 RAJONI

Votohet Qeveria e 43-të e Malit të Zi/ Shqiptari Dritan Abazović zgjidhet kryeministër

23-26 REALPOLITIK

Putin “wins” in Belgrade and Budapest! The Battle for Elysée and Europe! The German “NO” for “Open Balkans” Sofia spoke, what about Skopje?

Europe won in Paris and Lubljana! More was expected! Missed the mark! Rain in Sofia, hail in Skopje! Decoupling looks like Cold Halva!

27-31 IN FOCUS

- Conference on energy focuses on turning Albania into an energy exporter as crisis aggravates

- Serbia military beef up worries Kosovo, Albania’s PM unnerved

- Dritan Abazovic becomes Montenegro’s new PM as Parliament voted in his minority government

- Varhelyi praises Albania’s role in the Ukraine war, PM Rama declares decoupling from North Macedonia

- Pope Francis said entire “world is at war” understanding why weapons are bought by governments to defend themselves

ARQIPESHKVI ARJAN DODAJ

përcjellë mesazhin e tij për festën e Pashkës

Drita e prezencës së Zotit nuk e braktis kurrë njeriun!



igilja e natës së Pashkëve u kremtua në Katedralen e Shën Palit në Tiranë për herë të parë mesnatën e së dielës pas 2 vitesh nga pandemia e Covid-19.

Arqipeshkvi i Kryedioqezës Tiranë-Durrës, Imzot Arjan Dodaj ka përcjellë mesazhin e tij për besimtarët katolikë për festën e Pashkës.

Në mesazhin e urimit, Imzot Dodaj shprehet se "ringjallja e të kryqëzuarit ka një forcë dhe domethënie për mbarë njerëzimin dhe mbarë botën. Sot Krishtin që vdiq në kryq për ne, e shohim në shumë vëllezër dhe motra të pafajshëm viktimë të padrejtësisë, të dhunës dhe të luftës". Ai thekson se "me Krishtin në këto Pashkë shohim betejën e madhe të njerëzimit midis jetës dhe vdekjes, midis shpresës dhe dëshpërimit tundimit ndaj dorëzimit të së keqes dhe luftën për të mirën". "Ftesa që na ban Zoti të gjithëve sot është që të shohim me vendosmëri të ardhmen sepse përballë errësirës që njerëzimi ka në horizontin e sotëm, me të vërtetë depërton drita e prezencës së Zotit që nuk e braktis kurrë njeriun", shprehet Arqipeshkvi Metropolit Tiranë-Durrës.

"Jo rrallëherë, jeta dhe dinjiteti i njeriut vuajnë çekuilibrimin, kur janë të shkelura të drejtat e punëtorëve në kategori të ndryshme: nga fermerët e thjeshtë, te punëtorët e fasonerive; nga pensionistët me të ardhura të pamjaftueshme, tek ata persona me aftësi të kufizuara të cilëve u mungon një mbështetje më e përshtatshme; nga studentët me premtime të pa mbajtura, te të rinjtë prehë e krimi të organizuar dhe e përdorimit të substancave narkotike; nga familjet që shpeshherë nuk arrijnë të plotësojnë nevojat dhe ëndrrat e fëmijëve të tyre e më keq akoma, te dimri demografik i shumë lindjeve të munguara shpeshherë si pasojë e varfërisë edhe në vendin tonë".

Pra, kemi nevojë për Pashkë, për Ringjallje, për Rilindje, për Risi: në shoqëri, në politikë, në sipërmarrje dhe në edukim: për të rimëkëmbur një popull që përballë sfidave i dorëzohet tundimit të emigrimit, përballë mosrealizimit të premtimeve i dorëzohet indiferencës, përballë padrejtësisë i dorëzohet heshtjes, thekson Imzot Arjan Dodaj në Homelinë e Vigijljes së Pashkëve.



Ftesa që na ban Zoti të gjithëve sot është që të shohim me vendosmëri të ardhmen sepse përballë errësirës që njerëzimi ka në horizontin e sotëm, me të vërtetë depërton drita e prezencës së Zotit që nuk e braktis kurrë njeriun.



Arqipeshkvi Arjan Dodaj



Krishti është Ringjallur!

K

ëtu është zemra e fesë sonë; këtu është ajo brazdë që shënon ndarjen e vërtetë midis njerëzve.

Ata qëpranojnë lajmine Pashkëve, e dinë që nuk do të jenë më të burgosur të një bote të vogël e të mbyllur në interesat e një rrethi të ngushtë, që nuk të lejon më të shohësh në horizontet e reja e kështu në këtë vështrim, nuk dinë tëshohin më tjetër, përveçse humnerat e asgjësë. Ata që besojnë në Krishtin e Ringjallur e ngrejne kokën lart, shëkëputen nga interesat e tyre banale, mediokre e kalimtare, nuk kanë frikë ta shpallin bukurinë e së vërtetës. E verteta pa bukurinë është vrastare, bukuria me të vërtetën dëfton mëshirën dhe dashurinë Hyjnore. Dashuria e Zotitka hapur një shteg qëështë më i fortë sesa vdekja; për të cilin tani edhe ne kemi një kalim më të lirë nëMbretërinë dhe Shtëpinë e Atit qiellor, ku Jezusi është ngritur për të na përgatitur njëbanesë.

Të ringjallemi, në Krishtin e me Krishtin, është edhe destinacioni ynë: që do të thotë të emigrosh përtej, mbi një tokë ku nuk lotohet më, nën qiejtë ku më në fund banon drejtësia. Sa lot shohim që derdhen në këtë kohë mbi tokën e shkretë e të djegur, nga forca e ferrit që dëftohet nëpërmjet luftës. Sa familje, veçanërisht gra dhe fëmijë, enden në emigrimdrejt një toke ku nuk ka luftë e mund të gjejnë paqe. Sa shumëka nevojë bota sot

për Krishtin e Ringjallur, Princin e Paqes! Sa shumë kam nevojë unë dhe ke nevojë ti për takimin me Princin e Paqes. Krishti është ringjallur këtu tani për ty, vendose emrin tënd. Sonte në këtë natë do të bëjnë takimin me Krishtin e Ringjallur vëllezërit tanë që do të pagëzohen e do të na kujtojnë që një ditëKrishti i Ringjallur na kishte bindur edhe ne të ishim të Krishtit.

Me Krishtin e Ringjallur çdo vuajtje është kalimtare. Pashkët janë garancia që e keqja në fund do të mundet, ndonëse ajo bën shumë zhurmë, ndonëse mbjell shumë rrënoja dhe që mund të japë përshtypjen që ka sukses - por ky sukses i së keqes është i shkurtër - sikurse ka qenë për 3 ditë ndajKrishtit të Kryqëzuar.

Mbi mashtrimin, padrejtësinë, urrejtjen, shtypjen e të pafajshmit, do tëfitojë e vërteta, do të ngadhënjejëjeta, do të triumfojëdashuria. Vëllezërit e mi, duhet ta pyesim veten a besojmë akoma në forcën e dashurisë, a dimë akoma të dashurojmë, a lejojmë akoma që të dashurohemi e a presim që dikush të na dashurojë! Kemi humbur ABC-në e jetës, kemi humbur atë që është forma më klasike dhe më e thjeshtë e fillimit të jetës.

I Njëlinduri i Atit, qëështë bërë njeri, në mënyrë të pandashme është lidhur me brezninë dhe fatin tonë dhe ka hyrë si i Parëlinduri i një pafundësie vëllezërisht në parajsën e Hyjit, që tashmëështë bërë edhe jeta jonë. Jeta jonë nëpërmjet pagëzimit quhet parajsë, ndonëse në një luginë lotësh ne e dimë që në zemrat tona, Krishti nëpërmjet pagëzimit ka mbjellur atë shpresë, që nuk do të zhgënjëjë kurrë.

Duke u ringjallur, Krishti i ka çliruar ditët tona të shkurtra e të pafata, nga frika e asgjësimit e nga tmërri i perspektivës pa shpresë, që gjithçka në ekzistencën tonë do të mbarojë. Kjo është perspektiva njerëzore, thjesht horizontale, pa takimin me Krishtin, me Krishtin që na dëftohet nga lartësia e kryqit.

Në dëshminë e fesë, që ne bëjmë përballë të gjithëve themi: "Pres ringjalljen e të vdekurve." A e themi këtë seriozisht?

Shën Pali thotë që: "Nëse të vdekurit nuk ringjallen, atëherë as Krishti nuk është ringjallur, por nëse Krishti nuk është ringjallur, është e kotë feja jonë e ju jeni akoma në mëkatet tuaja...Nëse kemi shpresë në Krishtinvetëm për këtë jetë, ne jemi më fatligë se



E SHTUNA E MADHE

Qoftë lëvdur Jezu Krishti!

I dashur imzot Luigi Bonazzi, Nunci Apostolik, të dashur vëllezër e motra, këtë natë nga çdo altar, Kisha i shpall botës lajmin më të jashtëzakonshëm, më ngushëllues dhe më ripërtëritës të historisë:

"Krishti Zot, është Ringjallur!"

Ky mesazh, dëftohet në një plotësi që kapërcen çdo pritshmëri e shpresë të patriarkëve e profetëve antikë, që kemi dëgjuar ndër shekuj të bëhen të gjalla nëpërmjet leximeve dhe kësaj vigjiljeje të shenjtë. Përmban, e veçanërisht përcjell ky mesazh përvojat plot mrekulli e gëzim që dëshmitarë të përzgjedhur kanë bërë, duke takuar Atë që ka qenë i Kryqëzuar dhe për më tepër, duke biseduar e ngrënë me Të.



gjithë njerëzit. "(1 Kor15,16-19)

Po, këtë mbrëmje ne nuk po bëjmë një shfaqje, nuk po zhvillojmë një teatër. Ne me të vërtetë takojmë Krishtin e Ringjallur, si Maria Magdalenë, si Pjetri dhe Gjoni. Krishti i Ringjallur na merr për dore të gjithëve, siç ka bërë në ditën e pagëzimit.

Nëse rikthehem te besimi i vërtetë mbi Ringjalljen e Krishtit e tonën, ja pra që kemi nevojë të kërkojmë një hir të veçantë për të gjithë besimtarët nëkishën tonë, që të bëhemi lajmëtarë ungjillëzues dhe apostuj të mesazhit të Pashkëve. Të shpallësh Ringjalljen e Krishtit, që është edhe arsyeja e ringjalljes sonë, nuk është pra vetëm një angazhim i klerikëve, apo të përkushtuarve, por ico të pagëzuari dhe çdo personi që e ka takuar të Ringjallurin. Vëllezërit e mi, kjo është sfida jonë, kjo është arsyeja, nëse shoqëria jonë shkon mirë apo shkon keq, nëse të krishterët dinë të jenë kripa e tokës, drita e botës, apo nëse pagëzimin e tyre para se të zgjohen në mëngjes e të dalin

nga shtëpia e lënë nën jastëk, thua se kanë ndonjë thesar për ta fshehur për vete. Identiteti ynë pasurohet kur bëhet për të tjerët, me të tjerët, së bashku me të tjerët. Pikërisht kjo, do të thotë të nënvizosh se sa e çmuar është përballë Hyjit, jeta dhe dinjiteti i njeriut.

Jo rrallëherë, jeta dhe dinjiteti i njeriut vuajnë çekuilibrimin, kur janë të shkelura të drejtat e punëtorëve në kategori të ndryshme: nga fermerët e thjeshtë, te punëtorët e fasonerive; nga pensionistët me të ardhura të pamjaftueshme, tek ata persona me aftësi të kufizuara të cilëve u mungon një mbështetje më përshtatshme; nga studentët me premtime të pambajtura, te të rinjtë prehtë e krimit të organizuar dhe e përdorimit të substancave narkotike; nga familjet që shpeshherë nuk arrijnë të plotësojnë nevojat dhe ëndrrat e fëmijëve të tyre e më keq akoma, tedimri demografik i shumë lindjeve të munguara shpeshherë si pasojë e varfërisë edhe në vendin tonë.

Pra, kemi nevojë për Pashkë, për Ringjallje, për Rilindje, për Risi: në shoqëri, në politikë, në sipërmarrje dhe në edukim: për të rimëkëmbur një popull që përballë sfidave i dorëzohet tundimit të emigrimit, përballë mosrealizimit të premtimeve i dorëzohet indiferencës, përballë padrejtësisë i dorëzohet heshtjes.

Krishti është shpresa jonë! Krishti i kapërcet dorëzimet tona! Krishti i kapërcen dorëzimet tona!

Të kremtojmë Pashkëdo të thotë për ne ta ringjallim shpresën, sepse Jezusi i Ringjallur është Zot i Gjithësisë e me Të e dimë që njerëzimi nuk mund të shkojë më në harresë. Me Krishtin nuk je i harruar, ndonëse në jetën tënde të përditshme pas një premtimi menjëherë të harrojnë. Me Krishtin jo, nuk është kështu! Njëhiri madh shëlbues e ka prekur tokën me atë mëngjes pranvere, me Ringjalljen e Krishtit; ku përpara Maria Magdalenë dhe gratë e tjera, pastaj Pjetri e apostujt, e gjejnë varrin bosh. Secili prej nesh, këtë natë, të angazhohet që ky hir Hyjnor të zbresë thellë në sekretin e zemrës së tij, për të qenë arsye shprese dhe jete, për të gjithë ata që ka nën përgjegjësi, që mos të jemi më kurrë Kain për njëri-tjetrin.

T'i besohemi në këtë natë Virgjërës Mari me fjalët e Papa Françeskut, drejtuar asaj më 25 Mars në Aktin e Përkushtimit:

"Përmes teje o Mari, ardhte në Tokë Mëshira hyjnore dhe regëtimja e ëmbël e paqes i shoqëroftë ditët tona. O Grua e Po-së, mbi të cilën zbriti Shpirti Shenjt, riktheje mes nesh harmoninë e Hyjit. Shuaja etjen zemrës sonë, Ti që "je e shpresës gurrë e pashterueshme". Ti që ia ke endur natyrën njerëzore Jezusit, na bëj zejtarë të bashkimit.

Ti që ke ecur nëpër rrugët tona, na drejto shtigjeve të paqes."

Atëherë, për shumë mot Gëzuar Pashkët!

Amen!

FITOI MACRON,

Franca dhe Europa!

Nga DR. Jorgji KOTE

M

ë 24 Prill, politika, media dhe publiku në Europë dhe gjithandej ishin në Paris dhe në Francë, ku u zhvillua ballotazhi për zgjedhjet presidenciale midis Emmanuel Macron dhe kandidates karizmatike të "Rassemblement National (Bashkimi Kombëtar) të ekstremit të djathtë, Marine Le Pen. Ishte një betejë e vërtetë politike dhe zgjedhore; jo vetëm se bëhet fjalë për Francën, bashkëthemelues i BE-së, vendi më i madh në BE me Gjermaninë; mbi të gjitha mbasi është vendi i parë i madh ku konkuroi për zyrën më të lartë të shtetit partia më e madhe e ekstremit të djathtë. Kjo ndodhi mbasi në raundin e parë më 10 Prill, Macron siguroi 27,8 për qind të votave, ndërsa Le Pen u rendit e dyta me 23,1 për qind.

Ja pse rezultatin e këtyre zgjedhjeve dhe sidomos fitoren e Macron mezi e prisnin jo vetëm në Francë por dhe në Uashington, Berlin, Londër, Romë, Bruksel dhe kudo gjetkë. Për fat të mirë nuk u zhgënjyen me rezultatin, edhe pse nën nivelin e 5 viteve më parë, por më i lartë se parashikimet. Macron fitoi me 59 për qind kundrejt 41 për qind të Marine Le Pen, me një pjesëmarrje në votime prej 72 për qind. Në fitore pa shkëlqim, me rënie 7 për qind më 2017, por gjithsesi e trefishtë, për Macron, Francën, por dhe Europën dhe më gjerë.



Sepse 24 Prilli shkonte shumë më larg se kufijtë e Pallatit presidencial dhe të vetë Francës. Elysée-ja u kthye në "fushë-betëjën" e madhe për gjithë Europën.

Sfidantja e Presidentit aktual Macron ishte sërish 53 vjeçarja Marine Le Pen, liderja populiste e "Rassemblement National", organizata më e madhe dhe më aktive e ekstremit të djathtë dhe e gjithë forcave të tjera të ngjashme në Europë. E njohur për

qëndrimet e saj armiqësore ndaj emigrantëve, vlerave perendimore, mulilaterizmit, NATO-s, BE-së, etj.

Le Pen është aleate besnike e Rusisë, aq sa e quajnë dhe Marine Putin. Megjithë manovrat e saj taktike në fushatë dhe sidomos në debatin televiziv më 20 Prill me Macron, ajo nuk arriti ta fshihte këtë realitet të hidhur për të. Për pasojë, nëse fitonte më 24 Prill, kjo do të ishte një fitore tjetër, madje e bujshme politike e

Putinit, pas atyre në Budapest dhe Beograd; sepse vërtet që beteja e tij ushtarakisht zhvillohet në Ukrainë, por lufta politike ndërkombëtare është e zhvendosur në Bruksel, Paris, Londër, Berlin dhe Uashington. Mbi të gjitha, fitorja e Le Pen do të ishte nxitje dhe inkurajim i madh për homologët e saj në Itali, Gjermani, Spanjë dhe gjetkë.

Fitorja e saj do të sillte një ndryshim radikal të politikave të brendshme dhe të jashtme franceze, qëndrime armiqësore dhe kufizime të mëdha për emigrantët dhe ndaj organizatave ndërkombëtare, në radhë të parë NATO-s dhe BE-së. Megjithë disa ndryshime taktikash dhe fasadash, themelet e politikës së saj anti – Euro&Atlantike kanë mbetur të pandryshuara. Ndonëse ajo nuk foli si më si më parë për FREXIT, dmth daljen jashtë, por “ ribërjen “ e BE-së, ku fuqinë do të kenë shtetet kombëtare dhe jo Brukseli, ajo do të kërkonte ndër të tjera, rishikimin e traktateve dhe shkurtimin e ndjeshëm të kontributeve financiare të Francës çka do të krijonte turbullira të shumta politike dhe financiare brenda BE-së.

Ndërkohë, ajo është kundër NATO-s dhe sidomos bashkëpunimit me Gjermaninë. Mirëpo kjo e fundit do të disekuilibronte boshtin historik franko-gjerman, “motorri” i funksionimit të BE-së, me pasoja të pallogaritshme për gjithë Europën.

Rrezikshmëria e Le Pen qëndron dhe në faktin se si kryepopuliste karizmatike, me forcën e saj politike dhe aleatët në Francë, ajo kryesisht etiketon, kritikon, denigron, mohon, denoncon dhe kërkon “ qiqra në hell”, duke abuzuar me problemet dhe vështirësitë e shumta në përditshmërinë e francezëve të thjeshtë; premtimet e saj të bujshme për uljen e moshës së pensionit, rritjen e fuqisë blerëse, etj, dhe pse pa kurfare analize dhe përvojë qeveritare tingëllojnë vërtet “ muzikë” për një numër të madh zgjedhësish të pakënaqur, por me



Le Pen është kundër NATO-s dhe sidomos bashkëpunimit me Gjermaninë. Mirëpo kjo e fundit do të disekuilibronte boshtin historik franko-gjerman, motorri i funksionimit të BE-së, me pasoja të pallogaritshme për gjithë Europën.



pasoja të pallogaritshme për ta. Kështu, ulja sipas propozimit të saj e moshës së pensionit në 62 vjeç do t'i kushtonte shtetit mbi 60 miliard Euro shtesë.

Lidhur me emigrantët e huaj, Le Pen kërkon të mbulojë largimin e tyre si të padëshiruar, duke u dhënë shtetasve francezë përparësi ligjore në arsimim, punësim dhe në trajtimet e tjera social-ekonomike. Mirëpo, kjo bie në kundërshtim me parimin e shenjtë të barazisë, të mishëruar në Kushtetutë dhe kështu me radhë.

Problemi tjetër i madh këtë radhë është se partitë e ekstremit të djathtë dhe të majtë janë rritur ndjeshëm sidomos në Francë, duke shfrytëzuar pakënaqësitë dhe zhgënjimin te njerëzit e thjeshtë pas gjithë këtyre krizave. Raundi i parë zgjedhor më 10 Prill dëshmoi se dy ekstremet e majta dhe të djathta në Francë mbizotërojnë me rreth 60 për qind të elektoratit. Ndërkohë që dy partitë tradicionale, ajo socialiste dhe konservatore vazhdojnë tatëpjetën e tyre politike. Në raundin e parë, Kryebashkiakja e Parisit, socialistja

Anne Hidalgo dhe kandidatja e republikanëve Valerie Pécresse, e cila pretendonte se ishte “2/3 Thatcher dhe 1/3 Merkel” nuk siguruan të dya bashkë as 5 për qind të votave!!!. Gjithashtu, në balotazhin e 24 Prillit, për herë të parë në historinë zgjedhore franceze, vetëm Partia e Le Pen siguroi mbi 40 për qind të votave, ose 7 për qind më shumë se më 2017!

Për pasojë, në Francë është shtuar ndjeshëm Euroskepticismi. Gjithsesi, ndryshe nga parashikimet e mëparshme, në përfundim të fushatës zgjedhore u shtua numri i mosbesuesve ndaj Le Penit. Kjo mbasi siç e shigjetoi atë Macron, “ ajo ka vetëm “ fantazi politike” me një program që fillimisht do sqaruar, ndërsa Macron kishte një program bindës, të verifikuar dhe fitues, pavarësisht nga dritëhijet e pamohueshme.

Veç kësaj, shpresa për një fitore bindëse të Macron ishin të pavendosurit dhe votat e partisë së ekstremit të majtë të Jean Luc Melenchon, i cili siguroi 22 për qind më 10 Prill. Sipas të dhënave më të

fundit, në përgjigje të thirjes së tij që asnjë votë të mos shkonte për Le Pen, 66 për qind e tyre votuan për Macronin, çka duket se u konsolidua pas suksesit të tij të dukshëm në debatin televiziv të 20 Prillit ndërmjet dy sfidantëve presidencialë.

Më tej, Presidenti në detyrë, Emmanuel Macron dhe partia e themeluar prej tij "La République en Marche" erdhi duke i ka forcuar vazhdimisht pozitën, sidomos pas paraqitjes dinjitoze në debatin televiziv, ku bindi 60 për qind të votuesve. Ai përfaqëson pjesën më të moderuar europianiste të shoqërisë franceze.

Gjatë 5 viteve në Elysée, Macron e ka tregur vehtën menaxher të vërtetë të situatave dhe kampion të vlerave më të mira demokratike në periudha të jashtëzakonshme; pas trazirave sociale me "jelekverdhët" dhe Brexit, plasi kriza e koronës dhe shumë kriza të tjera të rënda, deri te lufta në Ukrainë me pasojat e saj. Mjafton të përmendet se megjithë situatat e jashtëzakonshme, niveli i papunësisë në Francë është më i ulët në 13 vitet e fundit!

Pas largimit të Merkel, ai është lideri më i besueshëm i një vendi të madh që bashkë me Gjermaninë dhe vende të tjera ka marrë në dorë dhe do t'i çojë më tej fatet e BE-së dhe NATO-s, me SHBA-ë dhe aleatët e tjerë.

Rikujtojmë me këtë rast se gjatë presidencës së tij, Macron ka bërë goxha me Merkel dhe aleatët e tjerë për BE-në, në sfidat e saj më të mëdha historike. Kështu, me nismën Franco-gjermane u miratua paketa më e madhe e ndihmave për COVID-19 për vendet më të prekura prej 750 Miliard Euro, në formën e borxheve që do të përballohen për herë të parë nga të gjitha vendet antare të BE-së, një "revolucion" i vërtetë në BE. Po ashtu, përmes debatesh dhe kompromisesh historike, u miratua për periudhën 2021 – 2027 buxheti më i madh në historinë e BE-së prej 2,4 Trilion Euro.

Ja pse, fitorja e Macron si europianist i shquar është një goditje e rëndë

për forcat populiste dhe ekstremiste në Francë dhe kudo. Brenda vendit do të vazhdojë procesi i reformave me ndryshimet e duhura që prekin jetën e përditshme të njerëzve. Në politikën e jashtme, do të ketë rrjedhoja pozitive për forcimin e multilaterizmit, të OKB-së, BE-së dhe NATO-s, në përgjithësi të Euro-Atlantizmit. Macron është artizan dhe partizan për një ndryshim cilësor, sidomos në funksionimin e BE-së. Ai ka hedhur me kohë disa ide sfiduese për një Europë të re, që



Pas largimit të Merkel, Macron është lideri më i besueshëm i një vendi të madh që bashkë me Gjermaninë dhe vende të tjera ka marrë në dorë dhe do t'i çojë më tej fatet e BE-së dhe NATO-s, me SHBA-ë dhe aleatët e tjerë.

të thellohet më shumë nga brenda, përpara se të zgjerohet më tej nga jashtë, por koha, ngjarjet, pandemia dhe zhvillime të tjera nuk i kanë dhënë kohën dhe hapësirën e duhur për realizimin e tyre.

Ca më tepër që këto zgjedhje përkojnë dhe me Presidencën franceze të BE-së deri në fund të muajit Qershor. Kur tashmë Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia kanë kërkuar antarësimin e tyre, krahas 6 vendeve të Ballkanit Perendimor. Si lider i një vendi të madh si Franca, Macron ka gjithë të drejtën e vet për t'u shprehur dhe sugjeruar ide dhe lëvizje të reja politike, me qëllim që BE-ja të mësojë dhe të shmangë gabimet dhe mangësitë e kaluara dhe t'i përgjigjet

sfidave të reja madhore në të gjitha fushat e sidomos në ato të mbrojtjes dhe sigurisë; që më në fund, të mos ngelë më "xhuxhmaxhuxh politik dhe krimb ushtarak".

Në këtë drejtim, Ballkani Perendimor ze vend të veçantë. Shenjë dhe mesazh i rëndësishëm i vëmendjes dhe interesit gjeopolitik francez për këtë rajon nevralgjik është organizimi në fund të muajit Qershor i një Konference të madhe të posaçme të BE-së mbi perspektivën e rajonit tonë. Nuk është fjala për samitet që kanë filluar të bëhen rregullisht çdo vit por për një konferencë, pra format më i gjerë, zyrtar dhe vendimarrës. Ai do të paraprihet nga Samiti i rregullt i BE-së më 14/15 Qershor, i cili me siguri do të miratojë një platformë të re strategjike për Ballkanin Perendimor, në dritën dhe zhvillimeve të reja pas agresionit rus në Ukrainë.

Megjithë vonesat e rastit, BE-ja me mbështetjen franceze vitet e fundit ka bërë goxha për rajonin. Ballkani Perendimor përfiton 3,3 miliard Euro për COVID-19, ndërsa për periudhën 2021 – 2027, BE-ja ka akorduar 30 Miliard Euro në kuadrin e Planit gjigand të Investimeve në këtë rajon. Po ashtu, Franca është ndër vendet më aktive të Procesit të Berlinit dhe mbështetëse e fuqishme e "Tregut të Përbashkët Rajonal" të Ballkanit Perendimor. Megjithë Jonë e saj dhe kushtet e caktuara më 2018-2019, Macron është partizan i çeljes së negociatave me vendin tonë dhe Maqedoninë e Veriut, pra dhe në këtë drejtim, Franca "nuk ka të sharë"

Ja pse, pavarësisht nga sfidat e mëdha e të vështira që e presin brenda dhe jashtë, sidomos zgjedhjet e reja dhe tejet sfiduese parlamentare në Qershor, fitorja e Macron po shoqërohet me interes dhe entuziazëm ngado në Europë dhe në botë, si një ogur i mirë dhe i mbarë për përparimin e mëtejshëm të BE-së, NATOS dhe Aleancës Perendimore në përgjithësi.

/Argumentum.al

© 2022 Argumentum

EKSKLUZIVISHT te ARGUMENTUM, pikat mbi "i" për 4 ngjarjet kryesore vetëm me 1000 fjalë nga diplomati dhe analisti i njohur DR. Jorgji KOTE

Putini "fiton" në Beograd dhe Budapest! Beteja për Elyseen dhe Europën! Jo-ja gjermane për Ballkan i Hapur! Sofja foli, po Shkupi?

REALPOLITIK "FLASH" NR. 43 01 – 15 PRILL2022

Nga DR. Jorgji KOTE

1. Putin "fiton" në Beograd dhe Budapest! Këto janë tituj të shtypit ndërkombëtar pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare në Hungari dhe në Serbi më 3 Prill. Në fakt, atje fituan bindshëm të dy liderët e njohur, Orban dhe Vuçiç, për arsye të përmendura dhe te ARGUMENTUM. Dihet se të dy janë aleatë të Putinit. Edhe pse Hungaria është antare e BE-së dhe NATO-s, ajo po krijon "demokracinë iliberale" duke sfiduar hapur BE-në. Të dy këto vende janë ndër të paktat që nuk kanë vendosur sanksione ndaj Rusisë. Natyrisht e kanë justifikuar këtë me faktin se ata janë për Hungarinë dhe Serbinë, as me Ukrainën e as me Rusinë. Beogradi ushqehet në "grazhdin" e Perëndimit, por dhe të Rusisë dhe Kinës. Ja, pse fitoret e Orban dhe Vuçiç konsiderohen të Putinit. Ironikisht për BE-në, ato janë "dhimbje e madhe koke"

2. Beteja për Elyséenë, selia zyrtare e Presidentit francez është logoja e zgjedhjeve presidenciale në Francë, raundi i parë i të cilave përfundoi më 10 prill, me fitoren e Presidentit Macro. Mirëpo, meqenëse nuk siguroi shumicën absolute, ashtu si 5 vjet më parë, Macron do të përballet në balotazh më 24 Prill me



kandidaten karizmatike të Bashkimit Kombëtar të ekstremit të djathtë, Marine Le Pen, me 4 për qind më pak. Por, 24 Prilli i kapërcen kufijtë e Pallatit presidencial. Elizeja është bërë "fushë-beteja" e madhe për Francën dhe gjithë Europën.

Kjo mbasi 53 vjeçarja Marine Le Pen, liderja populiste e Bashkimit Kombëtar, organizata më e madhe e ekstremit të djathtë në Europë është e njohur për qëndrimet armiqësore ndaj emigrantëve, vlerave perendimore, mulilateralizmit, dhe siddomos NATO-s dhe BE-së.

Megjithë disa ndryshime taktikash, themelet e politikës së saj anti-Euro – Atlantike kanë mbetur të pandryshuara. Ajo do të ribëjë BE-në, të heqë NATO-n dhe të prishë bashkëpunimin franko-gjerman, "motorri" i BE-së! Rrezikshmëria e saj qëndron dhe në faktin se si populiste tipike, ajo kryesisht etiketon, kritikon, denigron, mohon, denoncon dhe kërkon "qiqra në hell", duke abuzuar me problemet dhe vështirësitë e shumta në përditshmërinë e francezëve të thjeshtë.

Ndërsa Presidenti Macron dhe partia e tij "La République en Marche" përfaqëson pjesën më europianiste të shoqërisë franceze. Gjatë 5 viteve në Elysée ai e ka tregur vehten menaxher brilant të situatave dhe kampion të vlerave demokratike në periudha të jashtëzakonshme. Pas largimit të Merkel, është lideri më i besueshëm i një vendi të madh që me Gjermaninë dhe vende të tjera ka marrë në dorë dhe do t'i çojë më tej fatet e BE-së dhe NATO-s, bashkë me SHBA-të.

Fitorja e Macron do të ishte goditje e rëndë për forcat populiste dhe ekstremiste në Francë dhe kudo. Brenda vendit do të vazhdonte procesi i reformave me ndryshimet e duhura që prekin jetën e përditshme të njerëzve. Në politikën e jashtme, do të kishte rrjedhoja pozitive për forcimin e multilateralizmit, të OKB-së, BE-së dhe NATO-s. Ai ka hedhur me kohë disa ide sfiduese për një Europë të re, që të thellohet më shumë nga brenda, përpara se të zgjerohet më tej nga jashtë.

Ca më tepër që këto zgjedhje përkojnë dhe me Presidencën franceze të BE-së deri në fund të muajit Qershor. Kur tashmë Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia kanë kërkuar antarësimin e tyre, krahas 6 vendeve të Ballkanit Perendimor. Si lider i një vendi të madh si Franca, Macron ka të drejtën e vet për t'u shprehur dhe sugjeruar ide dhe lëvizje të reja politike, me qëllim që BE-ja të mësojë dhe të shmangë gabimet dhe mangësitë e kaluara dhe t'i përgjigjet sfidave të reja madhore në të gjitha fushat, sidomos në ato të mbrojtjes dhe sigurisë.

3. Jo-ja gjermane për Ballkan i Hapur u përmend sërish qartë me diplomaci nga Kancelari gjerman Olaf Scholz në Konferencën e Shtypit me me KM Rama më 11 Prill në Berlin. Natyrisht nuk mund të pritej, sidomos nga një personalitet si Scholz që shprehet vetëm afirmativisht që t'ia thoshte troç JO-në mysafirrit nga Tirana, ca më tepër, në takimin e tyre të parë njohës. Bota, e sidomos



Gjermania kanë mësuar me kohë se si të thonë “JO” të ngadalshme dhe diplomatike. Asgjë nuk ka për t'u habitur, madje Rama do të kishte bërë mirë të mos e kishte përmendur fare këtë temë. Sepse këtë JO e ka shprehur më parë në Tiranë dhe pse butë vetë Merkel dhe zyrtarë të tjerë të lartë gjermanë. Dhe Scholz në atë kohë ka qenë zv.Kancelar. Nuk ka se si Berlinit të pranojë Ballkan i Hapur, kur ti i thua açik se me atë do të zëvendësosh Procesin historik të Berlinit, meqenëse ai ka dështuar me një nismë nga Beogradi që dhe pas tri vitesh ka mbetur fare gjysmake! Kësaj i thonë “bishti më i rëndë se sqepari”! Pastaj, përse duhet të dalë “violinë e parë” Beogradi megjithë ato probleme që ka me Kosovën, me qëndrimet miqësore ndaj Rusisë dhe pas agresionit në Ukrainë dhe ca më tepër të mburret me fondet e BE-së? Kësaj i thonë “dhentë dhe dhitë e

Zeres, dhe nami i Hasan Qerres!”

Kryesorja, Gjermania dhe BE-ja, nisur dhe nga problematikat e nxehta ballkanike tashmë e kanë vulosur alternativën e tyre më të mirë për realizimin e katër lirive në rajonin tonë në Sofje, Brdo dhe më 14 Dhjetor 2021 në Bruksel në samitin zyrtar të BE-së! Në dokumentat e tyre shkruhet “e bardha në të zezë” vetëm për Tregu i Përbashkët Rajonal, i pranuar nga të gjashtë vendet. Kësisoj, Ballkani (gjysëm) i Hapur, është bërë mbivendosje fare e panevojshme.

4. Sofja foli, po Shkupi? Pas refreneve të mërzitshme mbi çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut këtë Qershor, më 12 Prill foli dhe Sofja zyrtare i nëpërmjet Kryediplomates së saj. Nuk dha asnjë shpresë për heqjen e vetos, duke përsëritur kërkesat e njohura ndaj Shkupit. Tani “topi luhet në portën” e Shkupit. Ama jo si deri tani kur ai ka pritur nga të mëdhenjtë, të cilët do të vazhdojnë demarshet por pa garanci për shkak të problematikave përvëluese. Tashmë dhe Shkupi duhet të bëjë lëshimet e kompromiset e duhura. Ndryshe, Sofja do t'i thotë “kthehu në vjeshtë”; si e keqja më e vogël, duke na marrë dhe ne me vehte. Se ndarjen nga Shkupi nuk e kemi ne në dorë, por vetëm Këshilli i BE-së.



/Argumentum.al
© 2022 Argumentum

Shqipëria, porta për në tregun evropian të gazit natyror

Drejtori i Përgjithshëm i “Excelerate”, Steven Kobos, në një intervistë të dhënë për revistën “Bloomberg” është shprehur se Shqipëria mund të jetë porta e gazit natyror në tregun evropian. Kompania amerikane e gazit natyror të lëngshëm “Excelerate Energy Inc.” pritet të furnizojë termocentralet lundruese në Shqipëri.



Drejtori i Përgjithshëm i “Excelerate”, Steven Kobos

Kompania amerikane e gazit natyror të lëngshëm Excelerate Energy Inc. do të furnizojë termocentralet lundruese në Shqipëri, duke shpresuar se marrëveshja do t'i mundësojë kompanisë akses në tregun evropian të gazit natyror.

Excelerate do të sigurojë maune me energji elektrike që do të gjenerojnë energji elektrike dhe do të forcojnë rrjetin në vendin e Evropës juglindore. Njëkohësisht, kompania po punon me Exxon Mobil Corp. për të zhvilluar një projekt të LNG-në-energjisë në portin shqiptar të Vlorës. Në partneritet me Albgaz Sh a në pronësi shtetërore të Shqipërisë dhe Snam SpA të Italisë, ajo shpreson të përdorë projektin LNG të Vlorës për të transferuar gazin natyror në vendet fqinje.

“Është një projekt i mirë energjetik për Shqipërinë”, u shpreh fillimisht miliardi i naftës.

Evropa po kërkon të diversifikojë furnizimet me gaz natyror për të ulur varësinë energjetike nga Rusia pas pushtimit të Ukrainës.

Administrata Biden po planifikon të eksportojë 15 miliardë metra kub gaz shtesë në Evropë këtë vit.

Çdo rritje e konsiderueshme e furnizimeve me LNG pasohet nga një rritje e infrastrukturës në Evropë.

“Excelerate” grumbulloi 384 milionë dollarë në një ofertë publike fillestare gjatë 12 prillit.

“Një pjesë e të ardhurave planifikohet të përdoret për projektin e Vlorës”, shkruan Bloomberg në përmbyllje.

Memorandumi

Më 17 mars të vitit 2021, gjigandi amerikan “ExxonMobil”, i cili është kontraktori i “Excelerate Energy”, do të nënshkruante një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) me qeverinë shqiptare.

Në të përfshihej edhe zhvillimi i një projekti të gazit natyror të lëngshëm në Portin e Vlorës.

LNG-ja do të sillte një larmishmëri të energjisë së rinovueshme dhe të përbalueshme në portofolin e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë.

Kjo, pasi vendi ynë mbështetet në energjinë hidrike, e

përhapur si praktikë dhe në rajonin e Ballkanit.

Sipas MoU-s, “Excelerate” do të kryejë fillimisht një studim eksplorimi, mbi potencialin e një zgjidhjeje të integruar të gazit natyror.

Studimi mund të përfshijë zhvillimin e një terminali importi, ku do të bëhet konvertimi ose zgjerimi i termocentralit ekzistues të Vlorës.

“Ndërsa Shqipëria kërkon të përmirësojë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e energjisë, ne kemi besim se LNG-ja do të sigurojë rinovueshmëri në rrjetin energjetik të vendit, duke plotësuar burimet e ripërtëritshme me ndërprerje dhe burimet alternative”, dekalroi Kobos një vit më parë.

Fillimi i punës së TEC-it është parashikuar në vitin 2023.

“ExxonMobil” nga ana tjetër do të ketë si detyrë identifikimin e mundësive, për të mbështetur furnizimin e LNG-së në Shqipëri.

Të njëjtin fakt përsëriste kryeministri shqiptar Edi Rama në tetor të vitit 2021.

Rama pohoi se Shqipëria po bashkëpunon me SHBA-të, për futjen e gazit të lëngshëm në Shqipëri.

Kjo do të mundësojë edhe një kalim të mundshëm në të ardhmen të TEC-it të Vlorës, me lëndë përpunuese gazin.

Kështu, duke minimizuar varësinë nga klima dhe natyra për prodhimin e energjisë.

Mbështetja në hidrocentrale

Shqipëria, edhe pse ka tetë sisteme kryesore lumenjsh, mbështetet te hidrocentralet.

Këto të fundit, mund të bëhen jofunksionale në kohë thatësire, për të furnizuar me energji gati 3 milionë banorë.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, Belinda Balluku, do të shprehej kohë më parë se diversifikimi i furnizimit dhe rritja e sigurisë së furnizimit janë thelbësore për Shqipërinë.

“Ne jemi të bindur se LNG-ja mund të jetë çelësi për arritjen e këtyre objektivave strategjikë dhe për t'i dhënë përfundimisht një zgjidhje projektit kompleks të Vlorës, duke zgjedhur partnerët më të mirë të pajisur për të afuar një projekt të një madhësie të tillë”, theksonte zyrtarja shqiptare.

Si një nga ofruesit kryesorë të zgjidhjeve për rigazifikimin LNG, “Excelerate” ka zhvilluar dhe operon në 13 terminale të gazit natyror në të gjithë botën.

Vizita e Donfried në rajon: Mesazhe të njohura, thellimi i lidhjeve me SHBA



izita e Ndhmës
Sekretares së Shtetit
për Çështjet Evropiane
dhe Euroaziatike
Karen Donfried në

Ballkanin Perëndimor këtë javë
ripohoi qëndrimet kryesore të
Shteteve të Bashkuara ndaj rajonit.
Kosova dhe Serbia duhet të
riangazhohen në Dialog me
qëllim të njohjes reciproke; SHBA
mbështet integritetin territorial
të Bosnjë-Hercegovinës dhe
kërkon zgjedhje në kohë dhe të
ndershme; Fillimi i bisedimeve
të anëtarësimit në BE me
Shqipërinë dhe Maqedoninë e
Veriut është shumë i vonuar –
këto ishin mesazhet kryesore të
turneut të Donfried në të gjashtë
vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në Serbi, sanksionet ndaj Rusisë, të
cilat vendi nuk i ka vendosur, ishin
gjithashtu një nga temat. Kjo nuk u
transmetua nga njoftimet për shtyp
të Presidentit dhe Kryeministrit
pas takimit të tyre me Donfried,
por Ndhmës Sekretari i Shtetit
konfirmoi se çështja tashmë është
“në tavolinë” në një intervistë
për të përditshmen Politika.
Pesha politike e vizitës mund t’i

“

**Administrata Biden ka treguar një gatishmëri
për t’u fokusuar në Ballkanin Perëndimor më
shumë se paraardhësit e saj, edhe para luftës në
Ukrainë dhe periudhës së tensioneve të rritura
brenda Bosnjë-Hercegovinës. Seria e fundit e
sanksioneve ndaj liderëve politikë të dikurshëm
dhe aktualë ka qenë një nga sinjalet se politika ndaj
Ballkanit Perëndimor mund të bëhet më e fortë.**

kontribuohet statusit të mesazherit dhe jo përmbajtjes. Vitet e fundit, diplomacia amerikane ndaj Ballkanit Perëndimor është menaxhuar rregullisht nga Zëvendës Ndihmës Sekretari i Shtetit i ngarkuar për rajonin, aktualisht Gabriel Escobar, ndërsa ardhja e një anëtari të administratës më të lartë sinjalizon një angazhim të intensifikuar. Administrata Biden ka treguar një gatishmëri për t'u fokusuar në Ballkanin Perëndimor më shumë se paraardhësit e saj, edhe para luftës në Ukrainë dhe periudhës së tensioneve të rritura brenda Bosnjë-Hercegovinës. Seria e fundit e sanksioneve ndaj liderëve politikë të dikurshëm dhe aktualë ka qenë një nga sinjalet se politika ndaj Ballkanit Perëndimor mund të bëhet më e fortë.

Nuk pati shumë njoftime për hapa të veçantë politikë gjatë vizitës së Karen Donfried, megjithëse disa u shfaqën. Në Maqedoninë e Veriut, për shembull, Ministri i Punëve të Jashtme Bujar Osmani njoftoi se më 2 qershor do të fillojë Dialogu Strategjik ndërmjet Uashingtonit dhe Shkupit.

“Ne jemi veçanërisht të nderuar që Maqedonia e Veriut do të bëhet vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që do të hapë Dialog Strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili do të thellojë partneritetin tonë strategjik dhe më konkretisht do të kornizë bashkëpunimin tonë dypalësh”, tha Osmani gjatë një konference për shtyp me Donfried më 28 prill. Dialogu Strategjik, një instrument i politikës së jashtme që Shtetet e Bashkuara vendosin në marrëdhëniet e tyre me një numër vendesh anëmbanë botës, duke përfshirë Kroacinë dhe Slloveninë, do të jetë një zgjidhje e rëndësishme afatgjatë për zhvillimin e Maqedonisë së Veriut, duke pasur parasysh se perspektivat e BE-së janë problematizuar nga vetoja nga



Bullgaria, thotë Misha Popoviq, Shef i Qendrës për Qeverisje të Mirë në Institutin për Demokraci Societas Civilis nga Shkupi.

“Do të thosha se SHBA-të nuk janë të vetme në këtë aspekt dhe ka iniciativa të tjera me vendet anëtare të BE-së”, thotë Popoviq për European Western Balkans. Gjatë konferencës me Osmanin, Dofried tha se Shtetet e Bashkuara duan të shohin sa më shpejt Konferencat e para Ndërqeveritare të BE-së me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

“Kjo Konferencë është shtyrë për shumë kohë. Ju keni përmbushur detyra dhe reforma të vështira dhe meritoni përparim të shpejtë”, tha Ndihmës Sekretari i Shtetit. Ky qëndrim i Shteteve të Bashkuara nuk është i ri. Tashmë në qershor të vitit të kaluar, Departamenti i Shtetit mbështeti zyrtarisht

mbajtjen e IGC-ve, por vetoja bullgare megjithatë mbeti në fuqi. Pas ndryshimeve të qeverisë si në Shkup ashtu edhe në Sofje, u bënë përpjekje për një afrim, por Bullgaria ende këmbëngul që pakica bullgare duhet të futet në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut përpara se të hiqet vetoja. Në ndërkohë, skepticizmi dhe zhgënjimi në Maqedoninë e Veriut po rriten. Dialogu Strategjik me Shtetet e Bashkuara, natyrisht, nuk mund të krahasohet me negociatat e anëtarësimit në BE, por gjithsesi mund të kontribuojë në procesin e reformave. Misha Popoviq beson se ky bashkëpunim do të synojë të përmirësojë qeverisjen dhe besueshmërinë e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. “Fokusi duhet të jetë në ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe pavarësisë institucionale, bazuar në aftësitë e



qëndrueshme kundër korrupsionit në sektorët kritikë dhe vendimarrje e cila është kompetente dhe vizionare dhe ofron perspektivë afatgjatë për qytetarët”, thekson ai. Marjan Gjurovski, asistent në Fakultetin e Sigurisë – Shkup, thotë se fillimi i paralajmëruar i dialogut strategjik ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së e ngriti në nivelin më të lartë partneritetin strategjik mes dy vendeve. “Ky aktivitet diplomatik është veçanërisht i rëndësishëm për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor kur kemi një depërtim të madh të ndikimit rus përmes kërcënimeve hibride. Besoj se marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Maqedonisë së Veriut në mbrojtje, ekonomi, arsim dhe teknologji informative do të forcohen përmes projekteve speciale”, shpjegon ai për portalin tonë.

Vuçiq dhe Rama nxjerrin në pah Ballkanin e Hapur

Pas takimit të Donfrid me presidentin serb Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrin shqiptar Edi Rama, të dy liderët theksuan rëndësinë e Ballkanit të Hapur dhe mbështetjen amerikane për të. Vetë

Donfried nuk e komentoi nismën. Sipas deklaratës së lëshuar nga Zyra e Presidentit të Serbisë më 26 prill, “Presidenti theksoi veçanërisht nismën e Ballkanit të Hapur si shembull të bashkëpunimit të suksesshëm rajonal dhe luftës për qëllime të përbashkëta, duke theksuar se është mënyra më e mirë për t’u përgatitur. Shtetet rajonale për anëtarësim në BE, por edhe një mundësi për të arritur standardet evropiane përpara se të anëtarësohen”.

Tre ditë më vonë, Edi Rama shkroi në faqen e tij në Facebook se foli me Dofridin për “progresin pozitiv të reformave, forcimin e drejtësisë, investimet strategjike në energji, veton e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut, situatën në rajon, si dhe mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara për Ballkanin e Hapur”. Udhëheqja aktuale e Serbisë dhe Shqipërisë janë forca shtytëse e nismës, e cila u shfaq, edhe pse më pak e theksuar, në një deklaratë për shtyp të kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski. Të tre vendet ranë dakord për të mbajtur një tjetër samit në kuadër të nismës në qershor. Vendet e tjera të rajonit deri më tani kanë refuzuar të anëtarësohen, me ish-kryeministrin e Malit të

Zi, Zdravko Krivokapiq, duke pretenduar së fundmi se Serbia po “shantazhonte” Malin e Zi për t’u bërë pjesë e Ballkanit të Hapur, ndërsa nisma nuk ishte e mirë për vendin. .

Qeveria e re e Malit të Zi, e zgjedhur të enjten mbrëmë, në programin e saj deklaroi se qëllimi i saj do të jetë “vlerësimi i iniciativave rajonale në kuadër të qëllimit kyç – anëtarësimi më të shpejtë të Malit të Zi në BE”.

Në një intervistë për transmetuesin publik malazez, Donfried ka reflektuar edhe për faktin se Qeveria e re ishte zgjedhur para ardhjes së saj. “Unë do të thoja që ju zgjodhët qeverinë e re vetëm për vizitën time. Nuk e di nëse e keni parashikuar këtë, as neve nuk e kemi pasur të qartë se si do të zhvillohen gjërat në Mal të Zi”, tha Donfried.

Sipas RTCG, ajo mohoi që Shtetet e Bashkuara të kenë lidhje me ndryshimin e qeverisë, por shtoi se është e qartë se qeveria e re është e përkushtuar për integrimin evropian, përmbushjen e angazhimeve të NATO-s, luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e reformave demokratike.

/Argumentum.al

Freedom House: Demokracia në Shqipëri regjim hibrid



Sipas raportit më të fundit të organizatës “Freedom House” për Vendet në Tranzicion, Shqipëria nuk ka pësuar asnjë ndryshim në pikë, krahasuar me një vit më parë, në të shtatë kriteret ku e bazon vlerësimin e saj kjo organizatë. Shqipëria vazhdon të përcaktohet në kategorinë e regjimeve hibride/demokraci në tranzicion, ku futen ato vende ku institucionet demokratike janë të brishta dhe ku ekzistojnë sfida thelbësore për mbrojtjen e të drejtave politike dhe lirive civile.

Në raport thuhet, se në Shqipëri qeverisja në nivel kombëtar është demokratike, por e dominuar nga politika partiake klienteliste. Zgjedhjet janë përgjithësisht konkurruese, por ato shpesh dëmtohen nga blerja e votës, manipulimi me votat dhe mangësi të tjera. Po kështu, raporti vlerëson se shoqëria civile luan një rol disi aktiv në raport me debatin dhe interesat publike, por ajo vuan nga financimi i pamjaftueshëm dhe mospërfshirja e duhur në konsultimin e politikave, siç kërkohet me ligj.

Sipas “Freedom House”, media në Shqipëri është pjesërisht e pavarur dhe ofron njëfarë niveli vëzhgimi të kujdesshëm të punës së atyre që kanë poste publike, por shumica e pronarëve të medias, thuhet në raport, i përdorin platformat e tyre mediatike për të lobuar tek qeveria dhe partitë politike. Për sa i takon qeverisjes lokale, ajo shihet si demokratike, por seriozisht e pafinancuar dhe e pakualifikuar për të ofruar shërbimet adekuate për qytetarët.

Në raport vërehet se gjyqësori vijon të jetë nën një proces të vazhdueshëm verifikimi të pastërtisë së figurës së anëtarëve të tij deri në fund të vitit 2024, e për rrjedhojë funksionon vetëm pjesërisht. Prej fillimit të procesit të vetëingut, janë rritur pritshmëritë, se sistemi i drejtësisë do të jetë më efektiv dhe më i pavarur, por në raport thuhet se ai ende nuk ka dhënë prova konkrete se po vepron lirisht. Për sa i takon korrupsionit, në raport thuhet se ai vazhdon të jetë ende i përhapur, duke shkaktuar mosfunksionim në degë të ndryshme të qeverisë. Por raporti vlerëson se agjencitë e reja të zbatimit të ligjit, të krijuara, që nga viti 2019 po tregojnë rezultate inkurajuese në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Që nga viti 1995, raporti i “Freedom House” për Vendet në Tranzicion ka vlerësuar gjendjen e demokracisë në 29 vende, që shtrihen nga Evropa Qendrore në

Azinë Qendrore.

Organizata e bazon vlerësimin në shtatë kategori, siç janë procesi zgjedhor, shoqëria civile, pavarësia e medias, qeverisja demokratike në nivel kombëtar, qeverisja lokale, sistemi gjyqësor dhe pavarësia e tij, si dhe korrupsioni. Vlerësimi bëhet nga 1 deri në 7 pikë, ku 1 është niveli më i ulët i demokracisë dhe me 7 vlerësohet niveli më i lartë i saj. Qeverisja demokratike në nivel kombëtar mbetet në njëjtat nivele si dy vitet pararendëse, me 3.25 pikë (2020-2022), por megjithatë ky tregues ka shënuar ulje krahasuar me pesë vitet e tjera, prej 2015 deri 2019, kur llogaritej në 3.50 pikë.

Në treguesin e shoqërisë civile, Shqipëria vlerësohet me të njëjtën shifër si një vit më parë, 4.75 pikë, por kjo pasqyron një rënie në raport me 8 vitet pararendëse (2013-2020) kur ky tregues kishte ruajtur një konstante prej 5 pikësh. Sistemi gjyqësor dhe pavarësia e tij, sipas raportit ka mbetur në të njëjtat nivele prej vitit 2013, duke u vlerësuar me 3.25 pikë. Po kështu edhe korrupsioni që vlerësohet me 2.75 pikë prej vitit 2013.

Elementi i demokracisë për vitin 2022 vlerësohet në nivelet e vitit 2021, me 3.75 pikë, por që gjithsesi pasqyron një rënie krahasuar me një tendencë rritjeje, që u vu re prej vitit 2014 deri në vitin 2020.

Në raport thuhet se themelet e demokracisë në Shqipëri u vunë në provë në 2021, viti kur u mbajtën zgjedhjet e dhjeta parlamentare shumëpartiake, që nga rënia e komunizmit.

“Pjesa më e madhe e diskutimeve publike, para dhe pas zgjedhjeve, ishin të mbushura me akuza të ndërsjella dhe retorikë përçarëse nga udhëheqësit e partive kryesore politike dhe Presidenti, gjë që çoi në incidente të frikësimit publik, lëndimeve dhe madje edhe vdekjeve gjatë fushatave elektorale”.

Më pas në raport thuhet se në përgjithësi zgjedhjet parlamentare u administruan mirë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ishte në gjendje të ofronte mjete të reja teknologjike për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe teknologjitë e reja të numërimit u përdorën në qendra të ndryshme votimi. Por megjithatë, sipas raportit, integriteti i zgjedhjeve nuk ishte plotësisht i paprekur, për shkak të pretendimeve të besueshme për blerje votash, frikësim dhe dhunë.

SERBIA MES DY BOTËVE

BULETINI I KOMITETI TË HELSINKIT SERBI NR. 161*

Përktheu për Argumentum Xhelal FEJZA

Rendi ndërkombëtar po kalon nëpërmjet një strukture të thellë transformimi të sistemit politik botëror dhe të marrëdhënieve tërësore ndërkombëtare, e në këtë kuadër, edhe marrëdhënieve rajonale. Kjo reflektohet edhe në Ballkan cili është njëfarë arene e garimit të aktorëve të ndryshëm (ShBA, BE, Rusi, Turqi, Kinë etj).

Vetëm disa muaj për shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, ish këshilltari për sigurinë kombëtare Zbignjev Bzhezinski e paralajmëronte Perëndimin: Megjithëse “Lufta e Ftohtë u përmyll me fitoren e njëres palë dhe mundjen e tjetres ecuria vendimtare nuk garantoj pasoja të lëmuara”. Për sigurimin e paqes, theksonte Bzhezinski, ishte i nevojshëm “një vizion gjeopolitik me afat të gjatë” në mënyrë që të sigurohej qëllimi ambicioz: “dukuria e Rusisë postimperiale e cila është në gjendje të zërë vendin e saj të vërtetë në koncertin e kombeve udhëheqës në botë”.

Për rikthimin e saj në skenën globale Rusia është përgatitur për 20 vite rresht. Vladimir Putini, gjatë fjalimit të tij të famshëm, tashmë historik, në Konferencën e Munihut (2007) e paralajmëroi një gjë të tillë, në mënyrë që më vonë gradualisht filloi ta realizonte. Njëkohësisht punoi edhe me liderët dhe lëvizjet (e majta dhe të djathta) Perëndimorë të korruptuar, gjë së cilës mund të thuhet se ia arriti.

Agresioni ndaj Ukrainës është përgatitur gjatë me synimin për rikonstruktimin e fuqisë globale ruse të para viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Ambicjet perandorake janë shndërruar në prioritet të politikës së Putinit. Megjithatë, agresioni ndaj Ukrainës ka pasoja afatgjatë në ndryshimet gjeopolitike, me pasoja ekonomike dhe financiare për të cilat duhet gjetur zgjidhje. Pavarësisht nga ecuria përfundimtare, lufta në Ukrainë ka për të ndryshuar rrënjësisht kuadrin e sigurisë së Europës dhe raportet mes Lindjes dhe Perëndimit. Juval Noah Harari, intelektual i udhëheqës botëror, pohon se në Ukrainë

